



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E PWRGJITHSHME RREGULLATORE**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

- 1. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Projektim rikonstruksioni i shkollave “Ismail Qemali”,  
“Marigo Posio”, “4 Heronjtë ””**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**22114311-5;**

**72242000-3;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8,316,243.00 (tetë million e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e  
dyqind e dyzetë e tre) lekë pa TVSH;**

**Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:**

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

**Në përfundim të punës grupi u referua ne nenin 76 te VKM Nr 285, datë 19.05.2021, ku pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të shërbimeve, bazuar në nevojat e institucionit, kontratat e viteve të më parshme me të njëjtin objekt si dhe analizë në cmimeve që janë bërë për këtë procedurë, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Afati i realizimit të shërbimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e fillimit.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros minimale vjetore, duhet të jetë *jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

**8,316,243x0,4=3,326,497.2(tre milion e treqind e njëzetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë.2) lekë pa TVSH;**

---

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1 Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet.**

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**8,316,243x0,2=1,663,248.6(njw milion e gjashtwqind e gjashtwdhjetw e tre mijw e dyqind e dyzetw e tetw.6) lekë pa TVSH;**

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë license projektimi ose të kontraktoje me një operatore ekonomike projektuese të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr.943, date 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në

*ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim*". Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- Kat. 2 b)2 qendra tregtare; objekte social- kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore.
- Kat. 4 a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.c) Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit.h) Projektim i impianteve ngritëse të transportuese (ashensor, shkalle levizëse etj.)j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, tv, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj, për objekte civile e industriale.
- Kat. 5. b) Furnizim me ujë- kolektor shkarkimi

Si dëshmi duhet të dorëzojë kontratën/marreveshjen me shoqërinë projektuese dhe licencat përkatëse të kërkuara.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondojnë me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave 'Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim", Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkruara te Termat e Referencës në lidhje me objektin që do të projektohet si më poshte:

**Kat. 2 b)** Qendra Tregtare; Ogjekte social – kulturore; objekte kulti; objekte arsimore..

**Argumentimi:** Bazuar në Termat e referencës Objekti është shkollë, dhe gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**Kat. 4 a)** Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit.h) Projektim i impianteve ngritese e transportuese (ashensor, shkalle levizese etj.). Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonise, fonise,internetit, tv, acces kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj, për objekte civile e industriale.

**Argumentimi:** Bazuar në termat e referencës, godina parashikohet për funksionin që do të kryejnë të kënaqësive të plot të instalimeve hidro sanitare ( tualete, furnizim me ujë etj) si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**Kat. 5. b)** Furnizim me ujë- kolektor shkarkimi

**Argumentimi:** Bazuar në termat e referencës, për realizimin e objektit të parashikuar, parashikohet realizimi i kolektoreve të shkarkimit, furnizimi me ujë, etj , KUZ të cilat do të lidhen me rrjetin ekzistues të qytetit si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon stafin me kualifikimet e duhura, drejtues teknik të shoqërisë, të përfshirë në Licencën e Shoqërisë për Projektim, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licencë profesionale, CV dhe të figurojë në listepagesa për muajin e fundit të deklaruar, si më poshtë:**

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili strukture)
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi zbatues
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier gjeodet /Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 1 (një) Inxhinier elektrik
- 1 (një) Inxhinier elektronik

- 1 (një) Inxhinier mjedisi

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektiva të përshkruara të Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështiresie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilin kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi profil strukture**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilin gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekta godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) gjeodet** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të studimeve gjeologjike dhe hidrollogjike që parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri gjeolog/Hidrollogjik**, si pjesë e stafit teknik.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet të ketë sisteme mekanike, sisteme të ngrohjes nevojitet që për hartimin e projekteve të kemi prezencën e **Ing. Mekanik**.
- Punimet për shërbimet që ofrohen nga **inxhinieri gjeofizik/sizmiolog** bazuar pikave të licenses se kërkuar konkretisht për punime dhe vlerësime të inxhinierise gjeologo-sizmike, lind nevoja e prezencës së një inxhinier sizmiolog/inxhinier gjeofizik për kategoria të sipërcituar për vlerësimin sizmiologjik.
- Meqenëse objekti i ri parashikohet të ketë sisteme të vezhgimit të kamerave, sisteme audio vizive, rrjetin data të internetit etj nevojitet të kemi prezencën e **Ing Elektronik**.

- Meqenese objekti i ri parashikohet te kete hapësira të gjelbra, nevojitet qe per hartmin e projekteve te kemi prezencen e **Ing. Mjedisit**.

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe *stafin mbështetës* (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi zbatues
- 1 (një) Inxhinier hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V.

*Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur*

**Argumentim:** Ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika4/b te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Meqense kemi te bejme me ndertimin e nje objekti kompleks sic jane qendrat multifunksionale prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht :

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punësim mesatar **i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave**, për muajin e fundit te deklaruar vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve” për për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës të disponojë çertifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës i dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- **1 (një)** punonjës i pajisur me çertifikatë "**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga



Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes i dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten muajin e fundit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

- **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Auditues energjetik** (i certifikuar nga **Agjensia për Efiçencën e Energjisë në ndertesa**), (Për ekspertin Auditues Energjetik te paraqiten Certifikata perkatese leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise si dhe Kontrata e punes (e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë te pakten muajin e fundit). *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis**, (Për ekspertin e Mjedisit certifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten muajin e fundit).
- **1 (nje)** inxhinjer si **“Ekspert zjarrfikës”** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certifikate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten muajin e fundit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga anetari qe do te kryeje punimet e MNZ.*
- **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për **”Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”**, e dhëne nga nje organizem i akredituar certifikimi shqiptar ose i huaj.(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten muajin e fundit). *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1 (një)** Punonjes **Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I.** Renia nga lartesi, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme i dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për te pakten muajin e fundit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon

nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion ...., dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Gjithashtu kërkesa për Ekspert zjarrfikës është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, duke patur parasysh që një zë i rendesishëm në preventiv është edhe Sistemi i Mbrojtjes kundër Zjarrit

Nisur nga funksioni i tij, objekti i parashikuar të ndërtohet duhet të plotësojë minimalisht standardet infrastrukturore në fuqi, kundrejt institucioneve të arsimit të lartë. Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi d):

*d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundër zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.*

Projekti i zbatimit përmban të gjitha masat aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri, të paraqitura në materialet grafike të të gjithë projekteve, si dhe në prevetivin e punimeve, grafikun, relacionet dhe specifikimet teknike përkatëse. Masat për mbrojtjen nga zjarri përmbledhen në projektin e mbrojtjes nga zjarri. Zbatimi i saktë i të gjitha masave dhe punimeve për mbrojtjen nga zjarri është dmosdoshmëri dhe detyrim.

Në mbështetje të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, neni 39, pika 3, *projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

Referuar nenit 42 të po këtij ligji, *moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.*

Për ndërtimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2015, më sipër cituar dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, është e nevojshme që të angazhohet 1 (një) ekspert zjarrfikës, i cili duhet të jetë pjesë e stafit inxhinierik të OE.

Persa i perket kriterit të vendosur për audituesin e energjisë sqarojme se ky kriter është vendosur në përputhje të plote të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Është arsyetuar e nevojshme dhe e lidhur ngushte me objektin e kontratës vendosja e kësaj kerkese për stafin teknik pasi në procesin e ndërtimeve të reja rikonstruksioneve dhe përshtatjeve të objekteve, është e nevojshme prania e një specialisti auditues energjie. Specialisti auditues është person i trajnuar dhe i certifikuar për ndjekjen e zbatimit të normave, rregullave në lidhje me ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa. Certifikimi i tyre bazohet në ligjin Nr.9379, datë 28.04.2005 "Për efencën e energjisë", ligjit Nr.8937, datë 12.09.2002 "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa" si dhe VKM nr.38, datë 16.01.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa"

Persa i perket kriterit të vendosur për Përgjegjesin për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015 ky kriter është vendosur në përputhje të plote të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Është arsyetuar e nevojshme dhe e lidhur ngushte me objektin e kontratës vendosja e kësaj kerkese për stafin teknik pasi zbatimi i projektit kërkon që të gjitha materialet dhe pajisjet që do të vendosen në objekt të jenë cilësore dhe në përputhje me standartet europiane të cilësisë.

#### **2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë**

- **ISO 9001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose **ekuivalent**. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE*
- **ISO 14001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose **ekuivalent** *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE*
- **ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) (ose e perditesuar) - ose **ekuivalent**. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE*
- **ISO 50001-2011** (ose e perditesuar) mbi “Sistemin e menaxhimit të energjisë- ose **ekuivalent**. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari që do të kryejë punimet perkatese.*

***Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.***

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo

Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

**ISO 50001-2011** është standard ndërkombëtare, kjo ISO specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është të mundësojë një organizatë që të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin dhe konsumimin e energjisë.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes, bashkëngjitur DST ne SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*